

AKTIVITETI

“GJERGJ KASTRIOTI SKËNDERBEU “ARTE & FAKTE”

Në kuadër të 550 vjetorit të vdekjes së Heroit tonë Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu, të shpallur nga Qeveria shqiptare si Viti Mbarëkombëtar i Gjergj Kastrioti Skënderbeut, QNK “Arbnori” u ftua nga Williams Paterson University në New Jersey, respektivish nga Departamenti i Gjuhëve të Huaja dhe Kulturës, ku thelbi këtë vit është Shqipëria.

QNK “Arbnori” si bashkëorganizatore e aktivitetit, me shumë dinjitet paraqiti para publikut amerikan dhe atij të Diasporës në New York dhe New Jersey, aktivitetin “Arte & Fakte”, një përmbledhje shtruese e të gjitha fakteve në pikturë e skulpturë, libra e kopertina, filma e muzikë që janë shkruar e botuar, publikuar e afishuar nga data e vdekjes së Heroit Kombëtar e deri sot.

Synimi i kësaj ekspozije, përzgjedhur nga QNK “Arbnori dhe Departamenti i Gjuhëve dhe Kulturës në William Paterson University, ishte prezantimi i figures se Heroit tone Kombetar, nga të gjitha këndvështrimet, në një event prej 2 orësh para një publiku universitar amerikan.

"Art on Paper" është një nga eventet me të mëdha në New York, ku QNK "Arbnori" e ftuar në këtë event, mori si përvojë, si formë si dhe krijoi kontakte në mënyrë që në të ardhmen, në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës dhe Bashkinë e Tiranës, ajo synon të planifikojë një Art Expo International Tirana, ku sjellja në vëmendje e Galerive, e Muzeve private me iniciativë të tilla menaxhuese, do sjellë një risi në jetën e kryeqytetit tonë, sepse do bazohet në profesionalizëm dhe synime ambicioze.

QNK “Arbnori” synon që këtë përvojë ta propozojë, në mënyrë që brenda vitit 2020 Tirana të ketë një shanc të tillë në organizim, të ngjashëm, modest e internacional.

Në Washington DC, Drejtoresha e QNK “Arbnori”, në takim me Ambasadorin tonë Shkëlqesinë e saj znj. Floreta Luli Faber foli për mundësinë e një fotoekspozite me figurën e Skënderbeut në art, pikturë, skulpturë, libra, muzikë e film, në ambientet e Ambasadës, për gjatë Vitit Jubilar të Skënderbeut, para një publiku më të përzgjedhur që vetë ambasada ka një listë personash që kanë interes të njohin apo promovojnë Shqipërinë.